



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE PRONAVE TRANSPORTIT DHE SHËRBIMEVE

RELACION

Mbi miratimin e formës së kryerjes së shërbimit për mirëmbajtjen e varrezave publike dhe të dëshmorëve dhe shërbimin e varrimit për njesitë e qytetit (lagja 1, lagja 2 dhe lagja 3) nga Bashkisa Berat.

Të nderuar Këshilltarë!

Nevoja për të kryer studimin e kostos së shërbimit për mirëmbajtjen e varrezave publike dhe të dëshmorëve dhe koston e shërbimit të varrimit për njesitë e qytetit (Lagja1, Lagja2 dhe Lagja 3) lindi si domosdoshmëri e nivelit të shërbimeve që aktualisht kryheshin me nënkontraktor dhe shtrirjen e tyre në gjithë teritorin e bashkisë krahas përmirësimit të cilësisë.

Operatorit Privat, i përfundonte kontrata e lidhur me Bashkinë Berat në datë 11/11/2021. Në këto kushte u ngrit grupi i punës me urdhër të kryetarit të bashkisë Berat me nr.509 datë 15/09/2021, i ndryshuar për të kryer studimin e kostos për të dy shërbimet.

Në përfundim grupi i punës solli materialin teknik dhe financiar, i cili i është shoqëruar këtij relacioni.

Kalkulimi i kostos, për këto shërbime në katër variante financiare, por në përfundim të punës konkludon:

Varianti ekonomik i cili siguron një kosto efektive për mbulimin e këtyre shërbimeve në mënyrë të detajuar është në studim. Konkluzioni përfundimtar është propozimi që ky shërbim të mos jepet me nën kontraktor por të ofrohet me fondet dhe punonjësit e bashkisë.

Fondet e nevojshme krahasimisht me fondet e përdorura deri tani në vlerë absolute janë më të mëdha por:

- 1- Sikurse lexohet në material në studim ofrimi i këtij shërbimi do të mbuloj mirëmbajtjen e varrezave publike në të gjithë territorin e bashkisë, në varrezat e dëshmorëve dhe shërbimin e varrimit në qytet (shërbim që nuk përfshihesh në vlerë monetare në kontratën e mëparshme).
- 2- Ofrimi i shërbimit në zera të veçantë është më i zgjeruar duke shtuar kohën e ruajtjes së varrezave për 12 orë në varrezat publike, pastrimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve në 2 herë në vit dhe gjithë vjetore për rrugë dhe sheshe. Mirëmbajtjen e luleve dekorative duke përdorur gjithë atrakturën e nevojshme, gjithë vjetore dhe shtimin e tyre. Mirëmbajtjen e parcelave ekzistuese dhe atyre të reja duke shtuar shtrimin dhe pastrimin e rrugëve ndërmjet parcelave. Analitikisht studimi i shpreh në natyrë dhe në vlerë kostot e tyre për total për shërbimin e ofruar, sipas elementëve të kostos.
- 3- Sipërfaqet e varrezave publike krahasimisht me koston e shërbimit të mëparshëm janë shtuar si rezultat i shtimit të sipërfaqeve për varrezat e reja (e dokumentuar me shpronsimet e realizuara përfshi periudhat 2016 – 2021).
- 4- Ndryshimet ligjore me efekte në kosto për pagat e punonjësve kanë efektin e tyre ekonomik pasi në momentin e llogaritjes së parë ato ishin me pagë minimale 24,000 lekë ndërsa në studim janë kalkuluar me pagat e reja dhe paga bruto për një punonjës është 39,000 lekë.
- 5- Indekset e çmimeve dhe inflacioni nga viti 2016 deri në vitin 2021 kanë pësuar ndryshim me efekt në rritjen e kostos. Edhe në se ky shërbim do të prokurohesh me vlerën e faktit që realizojmë në vitin 2021 në shumën 3,6 milion lekë është totalisht e pa mundur për efektet e cituara në pikat e mësipërme.
- 6- Rritja e cilesisë së shërbimit do të reflektohet në: kujdes së shtuar, ruajtje dhe mirëmbajtje dhe disiplinim real së sipërfaqes së tokës së nevojshme për varrezat e reja, kryesisht kjo në zonat rurale. Kjo pasi çdo varrim do të kryhet në vëndet e përcaktuar dhe jo sipas dëshirës së individëve. Manaxhimi i kostos së tokës është kosto buxhetore, disiplinim dhe mirë menaxhim i saj.
- 7- Shtohen për çdo njësi nga 1 punonjës definitiv që do të realizojnë mirëmbajtjen e varrezave, monitorimin e sipërfaqes së tokës, ndërsa në kohën tjetër do të monitorojnë shërbimet komunale në njësi (trajtuar gjerësisht në njësi).

Sa më sipër kosto e mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve nga 3,6 milion aktualisht, studimi përlogarit vlerën prej 7,5 milion lekë.

Gjithashtu kosto e shërbimit të varrimit për qytetin përlogaritet në vlerën e 8 milion lekëve, këtu theksojmë se ky shërbim mbulohet nga të ardhurat e veta që sigurohen nga arkëtimet e tarifave për këto shërbime vendimuar në KB 2015 dhe përditësuar në studimin me kostot e reja që rezultojnë përafërsisht të barabarta. Ky barazim edhe pse bëhet për një periudhë prej 6 vjetësh vjen si rezultat i uljes së strukturës së kostos materiale dhe rritjes së pagave, nga këto diferencat janë të pa përfillshme në vlerë. Konkluzion ky që nuk prek buxhetin e bashkisë pasi barazohet kosto me tarifën. Përmbledhëse e kostos totale për një vit financiar

Nr	Emërtimi	Shuma Lek	Shërbimi i mirëmbajtjes	Shërbimi i varrimit
1	Kosto Personeli	10,881,808	7,072,720	3,809,088
2	Kosto Materiale	4,540,270	394,826	4,145,444
2.1	<i>Mat. per mirembajtjen e varrezave</i>	<i>394,826</i>	<i>394,826</i>	
2.2	<i>Mat. per sherbimin e varrimit</i>	<i>4,145,444</i>		<i>4,145,444</i>
3	Kosto Vegla, mjete pune	85,350	36,890	48,460
	Total kosto (1+2+3)	15,507,428	7,504,436	8,002,992

Sipërfaqet në total ku ofrohet ky shërbim

Nr	Emertimi	Sip. Totale m2	Sip e lire m2	Sip. Rruge&sheshe m2	Sip. Bime dekorative m2	Parcela
I	Varrezat publike	657,684	260,485	5,799	1,000	116
1	Suelas (Rajoni 3)	80,245	46,865	4,115	500	80
2	Burdullias (Rajoni 1)	35,380	11,658	1,684	500	35
3	Nj.A. Otllak	102,806	38,578			
4	Nj.A. Velabisht	123,933	46,487			
5	Nj.A. Sinje	255,535	94,437			
6	Nj.A. Roshnik	59,785	22,460			
II	Varrezat e Deshmoreve	4,190		1,754	1,610	4

Të dhënat e tjera analitike janë të shprehura në studimin e paraqitur nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim.

Ky relacion shpjegues vjen në K.B për miratimin e kthimit të shërbimit nga privat në publik.

Pergatiti:

Drejtör i Emergjencave Civile ,Pronave ,Transportit dhe Sherbimeve

Erlin Kuçi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Relacion: RIORGANIZIMIN E DREJTORISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE, NDËRMARRJES SË GJELBËRIMIT DHE KRIJIMIN E AGJENCISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE

Të nderuar këshilltarë!

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ndërhyrja në strukturë, miratimi i shtesës në numrin e përgjithshëm të të punësuarve, si dhe miratimi i nivelit të pagave për secilën kategori është e drejta e Këshillit të Bashkisë.

Një nga funksionet bazë të qeverisjes vendore janë edhe funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, këto të detajuara në legjislacionin në fuqi. Funksionet bazë të bashkive konsistojnë në :

- a) Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.
- b) Ndriçimin e mjediseve publike brenda territorit të Bashkisë Berat.
- c) Administrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve memoriale (Varrezat e Dëshmorëve) dhe rehabilitimin e mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit brenda territorit të Bashkisë Berat.
- d) Shërbimin e dekorit publik.
- e) Administrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve, lulishtetve dhe hapësirave të gjelbra publike brenda territorit të Bashkisë Berat që nuk përfshihen në kontratën e pastrimit.
- f) Administrimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të transportit (mjeteve të punës).

Bashkia Berat aktualisht i kryen këto funksione nëpërmjet dy ndërmarrjeve, Ndërmarrja e Gjëlberimit dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike. Për administrimin sa më të mirë dhe të unifikuar të këtyre funksioneve do të jetë më efikase bashkimi i këtyre funksioneve në një strukturë të vetme. Kjo do të rriste në të gjitha pikepamjet ofrimin e shërbimeve në të gjithë territorin e bashkisë. Krijimi i Agjencisë së Shërbimeve Publike do të ketë në përbërje të saj mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore, ndricim publik, mirëmbajtjen e hapësirave publike, mirëmbajtjen e varrezave publike

në të gjithë territorin e bashkise, shërbimin e dekorit si dhe administrimin e mjeteve të punës në këtë agjenci.

Ndërmarrja e Gjelbërimit si njësi shpenzuese pranë Bashkisë Berat do të bashkohet me njësinë tjetër shpenzuese Drejtorinë e Shërbimit Publik në një person të vetëm juridik, nga ky bashkim do të krijohet Agjencia. Me krijimin e Agjencisë së Shërbimeve Publike do të ndiqen procedurat për krijim e këtij personit juridik e cila do të riorganizohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në Agjencinë e Shërbimeve Publike dhe NIPT-ti nuk do të ndryshoj.

Kjo Agjenci do të ketë në përbërje të saj sektorin e mirëmbajtjes së rrugëve publike, ndricimit publik dhe dekorit, sektorin e gjelbërimit dhe pastrimit, sektori i transportit dhe sektorin e mirëmbajtjes së varrezave publike. Risi e re në këtë agjenci do të jetë krijimi i një skuadre punonjësish për pastrimin e hapësirave publike të cilat nuk janë të përfshira në kontratën bazë të pastrimit, si dhe zonave muzeale të qytetit, për të rritur imazhin pozitiv edhe për vizitorët vendas e te huaj.

Sektori i ndricimit publik dhe dekorit do të ketë në përbërje të saj inxhinier elektrik dhe elektrikista për hartim dhe zbatimin e projekteve elektrike si dhe mirëmbajtjen e ndricimit public në të gjithë territorin e Bashkisë Berat.

Gjiashtu në këtë agjenci do të krijohet edhe sektori i mirëmbajtjes së varrezave publike si një fukcion i shtuar rishtazi. Ju sqarojmë se :

Në Bashkisë Berat shërbimi i varrimit kryhej nga operatori ekonomik privat për një periudhë 5 vjecare për mbulimin e mirëmbajtjeve të varrezave në të gjithë territorin administrativ që mbulon bashkia. Pas përfundimit të mbarimit të afatit të kontratës me operatorin ekonomik ky shërbim do të kryhet nga drejtoritë e varësisë pranë Bashkisë Berat. Për këtë qëllim dhe ofrimin e një shërbimi sa më efikas për mirëmbajtjen e varrezave të qytetit dhe njësive administrative do të jetë e nevojshme një numër i caktuar punonjësish të cilët do të mbulojnë këtë shërbim. Kjo strukturë do të jetë pranë drejtorive të varësisë e cila do të kryej mirëmbajtjen si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit,.

Një risi e re në këtë agjenci është dhe krijimi i sektorit të transportit , i cili konsiston në administrimin e të gjitha mjeteve të punës nga të dy njësitë shpenzuese. Ky sektor do të ketë si detyrë koordinimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve në realizimin e shërbimeve në komunitet në një kohë më të shkurtër dhe më cilësore.

Agjencia do të përbëhet nga punonjësit e Ndërmarrjes së Gjellbërimit dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike si pasojë e bashkimit, me vetëm disa shtesa, të cila do të paraqiten në mbledhjen pasardhëse të Këshillit Bashkiak për miratim.

Për sa më sipër krijimi i Agjencisë së Shërbimeve Publike është shumë e domosdoshme dhe do të sillte shërbime me efikasë për të gjithë komunitetin dhe njësitë administrative duke i unifikuar të gjitha shërbimet dhe proceset që ofrohen nga bashkia në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike.

Përsa më sipër, duke ju falenderuar për mbështetjen tuaj, Ju ftoj ta votoni propozimet e mësipërme domosdoshmëri për funksionimin sa më të mirë të këtij shërbimi dhe punëve operative që do të ndiqen nga kjo agjenci.

Përgatiti: Arisa Toska

Petro Sinjari

Gentian Dashi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E BUJQESISE, ADMINISTRIMIT TE PYJEVE, UJERAVE DHE SHERBIMIT
VETERINAR

PËR MIRATIMIN E SASISË SË MATËRIALIT DRUSOR QË DO JU JEPET LEJE
FAMILJEVE NË ZONAT RURALE NË TERRITORIN E BASHKISË BERAT

KËSHILLIT BASHKIAK – BERAT

Të nderuar Këshilltar!

Bazuar në ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”I ndryshuar, ligjin nr 57/2020 “Për Pyjet”, si dhe në Vendim Nr.1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, VKM –sw 438 datë 08.06.2016 “Kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore, nga të dhënat që disponojmë për nevojat konkrete që kanë familjet në zonat rurale dhe sasisë së matërialit drusor (dru zjarri) e cila vilet realisht nga pylli si dhe në bazë të planeve të menaxhimit të pyjeve. Bashkia Berat duke patur parasysh kapacitetet dhe rritjen vjetore të volumeve të matërialit drusor propozojmë që :

Leja mbi sasinë e matërialit drusor (dru zjarri) për familjet në zonat rurale të jetë në masën 5 m³ për familje.

Bashkia Berat duke patur parasysh kapacitetet dhe rritjen vjetore të volumeve të matërialit drusor

Kërkojmë :

Miratimin e lejes mbi sasinë e matërialit drusor (dru zjarri) për familjet në zonat rurale të jetë në **masën 5m³** e cila bazuar në Vendim Nr.1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” dhe VKM 438 datë 08.06.2016 “Kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit te pyjeve dhe te shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”. e cila do ju vij në ndimë familjeve të zonave të thella rurale . Trajtimi dhe shfrytëzimi i fondit pyjor public/privat me qëllim sigurimin e

nevojave për ngrohje të banorëve të bashkive, rigjenerimin dhe shëndetësimin e pyjeve mbështetet në të dhënat e planeve të mbarëeshtimit dhe inventarizimit të tyre dhe ka si bazë ngastrat e nënngastrat pyjore.

Shfrytëzimi i fondit pyjor për këtë qëllim përmbledh ndërhyrjet dhe trajtimet silvikulturore në moshën e shfrytëzimit dhe kur është siguruar ripërtëritja natyrore.

Sigurimi i druve të zjarrit për ngrohje, nga banorët e fshatrave malore dhe në brendësi të pyjeve, kryhet edhe nëpërmjet mbledhjes (vlerësimit) të materialit drusor nga drurët e rrëzuar (shkulur e thyer) nga furtunat e zjarret dhe punimet e trajtimit rigjeneruese të pyllit, me rrallime e prerje sanitare e shëndetësimi, sipas projekteve të hartuara dhe vlerësimit paraprak në vëllim të materialit drusor. Projektet e hartuara dhe parcelat për shfrytëzimin e material drusor janë dërguar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për miratim.

Për plotësimin e nevojave të familjeve hartohet lista, në bazë fshati, nga Administratorët e Njësiave Bashkiake, miratohet nga drejtoria e Bujqësisë, Administrimi i Pyjeve ,Ujrave dhe Shërbimi Veterinar , në bashki dhe pas pagesës, sipas tarifave përkatëse në fuqi Vendim Nr.1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave, bëhet plotësimi i nevojave te familjet.

Efekti financiar bazuar në v.k.m.-në e mësipërme do jetë:

$$5m^3 \times 500 \text{ lek}/m^3 = 2500/ \text{ familje}$$

Bashkëlidhur me këtë relacion do të gjeni:

- Vendim Nr.1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave.
- V.K.M. 438 datë 08.06.2016 “Kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve tjera pyjore e jopyjor

Ju faleminderit!

DREJTORI D.B.AP.U & SHV

Bledar Cili





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 81 DATË 29.12.2020 " PËR
MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN 2021 DHE PBA 2021-2023 "**

Të nderuar këshilltarë!

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 40, pika 1, neni 41, pika c, 54, gërma "dh", neni 64 gërma "c", ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 6, gërma "d", neni 28, pika 5, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar , të ligjit nr. 137/2020 "Për Buxhetin e vitit 2021", Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin plotësues nr. 4 datë 25.01.2021 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021",

paraqesim propozimin për një ndryshim në buxhetin e Bashkisë Berat të vitit 2021 , buxhet i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 81 datë 29.12.2020 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2021 dhe PBA 2021-2023" , si më poshtë :

Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Grantit të nënshkruar ndërmjet Bashkisë Berat dhe Kompanisë TAP, nr protokoli 1658 datë 23.03.2021, ku parashikohet dhurimi i disa mjeteve për shërbimet publike të Bashkisë Berat, në nenin nr. 1, pika 1.2 të Marrëveshjes, parashikohet që mbulimi i kostove të TVSH dhe kostove që kanë të bëjnë me pagesat në doganë të mbulohen nga përfituesi, në këtë rast Bashkia Berat.

Në marrëveshje është parashikuar dhurimi i 8 mjeteve të reja me vlerë 455,008 eur.

Parashikimi i mbulimit të kostos së TVSH është përcaktuar në buxhetin e vitit 2021 të Bashkisë Berat në shumën 10,000,000 lekë.

Në periudhën e hartimit dhe miratimit të buxhetit (nëntor-dhjetor 2020) , palët kishin rënë dakord për projektin e dhurimit të mjeteve nga TAP me bashkëfinancim të bashkisë Berat për kostot lokale (tvsh dhe taksa e tarifa të tjera të nevojshme). Nga ana jonë u parashikua fondi për bashkëfinancim në shumën 10,000,000 lekë.

Në kushtet e tanishme të realizimit të projektit, kur mjetet janë duke u importuar nga Slovenia (vendi i furnitorit WEBO MARIBOR D.O.O) , dhe me kursin aktual të këmbimit të eur, lind nevoja e shtimit të fondit të bashkëfinancimit me 1,300,000 lekë, për mbulimin e TVSH dhe taksave në import për të gjitha mjetet.

Vlera e mjeteve është 455,008 eur, shumë e cila i paguhet furnitorit nga TAP.

Në muajin Nëntor'21, janë importuar 4 mjete: 1 kamionçinë, 2 miniekskavatorë dhe 1 rul vibruës (mjetet me numër rendor 1-3 në listën e mëposhtme), me vlerë 148,358 eur.

Nga fondi 10,000,000 lekë janë përdorur 3,650,265 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Në periudhën Nëntor- Dhjetor 2021 pritet të vijnë 4 mjetet e tjera: 2 kamionë, 1 mini ekskavator dhe 1 furgon, me vlerë 306,650 eur. (mjetet me numër rendor 4-7 në listën e mëposhtme).

Lista e mjeteve për shërbimet publike :

Nr	Pershkrimi	Gjendja	Sasia	Cmimi per njesi	Kosto Transporti	Total cmimi me transport
1	NISSAN Navara Cab N-Conecta 2.3 dCi D 190ps 4WD 6M/T, Black Color	I Ri	1	€ 29,580.00	€ 1,200.00	€ 30,780.00
2	CATERPILLAR 303.5E2 Mini Excavator 3.5t	I Ri	2	€ 41,989.00	€ 700.00	€ 85,378.00
3	CATERPILLAR Small Vibration Roller CC2.6 2.4T with steel in front and rubber on rear axle, Standard yellow black colour	I Ri	1	€ 31,500.00	€ 700.00	€ 32,200.00
4	CATERPILLAR 246D3 Skid Street Loader 3.3 t with bucket and fork, Standard yellow colour	I Ri	1	€ 54,700.00	€ 1,000.00	€ 55,700.00
5	IVECO Daily 50C16 Bucket Truck, Standard white green colour	I Ri	1	€ 72,000.00	€ 1,500.00	€ 73,500.00
6	IVECO Trackker AD410T50 Heavy Duty Truck, Standard white colour	I Ri	1	€ 128,000.00	€ 2,000.00	€ 130,000.00
7	MERCEDES BENZ Van, V250d long facelift, Black colour	I Ri	1	€ 46,250.00	€ 1,200.00	€ 47,450.00
Total			8			€ 455,008.00

Propozojmë :

1. Të bëhet shtesa në shumën 1,300,000 Lekë :

Në programin buxhetor 06260 Shërbimet publike vendore , të shtohet buxheti për artikullin 231 Investime Blerje mjeteve për shërbimet publike , Bashkëfinancim Kostot Lokale me TAP me shumën 1,300,000 lekë .

2. Të pakësohet me 1,300,000 Lekë artikulli i Shpenzimeve Operative, si më poshtë :

Në programin buxhetor 01110 Planifikim, menaxhim dhe administrim – të pakësohet fondi për artikullin 602 Shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes me 1,300,000 Lekë.

Fondi vjetor i planifikuar për këtë zë shpenzimesh është 36,177,000 Lekë;

Realizimi i deritanishëm është 22,200,000 lekë, dhe deri në mbyllje të vitit pritet të jetë 32,000,000 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Për sa më sipër, kërkohet të miratohet ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 81 datë 29.12.2020 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2021 dhe PBA përfundimtare 2021-2023" si më poshtë :

1. Ndryshime në programet përkatëse, në pasqyrën " Detajimi i buxhetit të bashkisë Berat për vitin 2021 sipas programeve", si më poshtë:

Pakësime

Emërtimi i programit	Kod Institucioni	Kodi i programit	Kap.	Llog.	Kod Projekti	Shuma LEK	
Planifikim, menaxhim dhe administrim	2102001	01110	05	602	9999999	1,300,000	Shpenzime te ndryshme operative
Totali						1,300,000	

Shtesa

Emërtimi i programit	Kod Institucioni	Kodi i programit	Kap.	Llog.	Kod Projekti	Shuma LEK	Emërtimi i projektit
Shërbimet publike vendore	2102001	06260	05	231	1020020	1,300,000	Blerje mjetesesh per sherbimet publike , Bashkefinancim Kostot Lokale me TAP
Totali						1,300,000	

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin ,

DREJTOR I MENAXHIMIT FINANCIAR DHE TË ARDHURAVE

Rovena Shehu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I DREJTORISË SË SHËRBIMIT SOCIAL TË BASHKISË BERAT PËR PERIUDHËN 1 –31 TETOR 2021.

Të nderuar këshilltarë ,

Drejtoria e Shërbimit Social, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 7/2, 8/2, 9 pika 1.1, gërma”b”, 21, 64 gërma”c” , të ligjit nr.57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, nenit 21,Vendimit Nr.597 datë 04.09.2019 “ Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondet e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” VKB. nr.2, datë 28.01.2021 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% dhe /ose me fondet e buxhetit vendor ”, si dhe VKM nr.8 datë 14.01.2015 e ndryshuar në datë 15.01.2019 “Për mbrojtjen e Shtresave në Nevojë, për efekt të heqjes së Fashës së Kompesimit të Energjisë Elektrike deri në 300 këh në muaj”, VKB nr.81 datë 29.12.2020 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe PBA përfundimtare 2021-2023”.

JU RELATON :

PËR BANORËT E BASHKISË BERAT DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE

Përfitojnë Ndihmë Ekonomike nga Fondet e Bashkisë Berat për muajin TETOR 2021

Nr.	Emri	Mbiemri	Refuzuar për	Vleresimi	Adresa e banimit
1.	Isa	Ruçi	Pikëzim	I vetëm me probleme shëndetësore jeton nën minimumin jetik.	Lagjia nr.1
2.	Llukan	Lapi	Pikëzim K.8	Familje me problem social-ekonomiek, dhe me sëmundje terminale.	Lagjia nr.3
3.	Brendi	Lika	Pikëzim	Me probleme sociale ekonomike dhe të shëndetit	Lagjia nr.1

15

				mendor.	
4.	Manushaqe	Kapllani	Pikëzim K.8	E/ve me probleme ekonomike të theksuara sociale dhe shëndetësore.	Lagjia nr 3
5.	Vjollca	Bega	Pikëzim	Probleme sociale-ekonomike dhe shëndetësore.	Lagjia nr.2
6.	Luan	Hajro	Pikëzim	I divorcuar jeton në varfëri totale .	Lagjia nr.1
7.	Aleksandër	Mahilaj	Pikëzim	I vetme me probleme të theksuara sociale dhe ekonomike .	Lagjia nr.1
8.	Eljona	Xhardo	Pikëzim	Nënë kryeamiljare me probleme sociale dhe ekononmike.	Nj.Adm Otllak
9.	Hysen	Karkanjozi	Pikëzim	Familje me probleme sociale dhe ekonomike.	Lagjia nr.1
10.	Mimoza	Kaçeli	Pikëzim	E ve me probleme social-ekonomike.	Lagjia nr.1
11.	Kozeta	Bakalli	Pikëzim	E vetme me probleme social-ekonomike.	Lagjia nr.1
12.	Dallandyshe	Rusi	Pikëzim	E vetme probleme shëndetësore social-ekonimke.	Lagjia nr.1
13.	Merita	Hasani	Pikëzim	Grua e ve me problem të theksuara social-ekonomike.	Lagjia nr.2
14.	Lida	Vodica	Pikëzim	Grua e ve me probleme sociale dhe ekonomike .	Lagjia nr.2
15.	Shefqet	Sadiku	Pikëzim	Familje me probleme sociale dhe ekonomike prej shumë kohësh e pa-punë.	Lagjia nr.1
16.	Albert	Dokollari	Pikëzim	I vetem problem social-ekonomike.	Lagjia nr.3
17.	Lutfi	Keci	Pikëzim	Familje me probleme sociale-ekonomike, pa të ardhura .	Lagjia nr.3
18.	Kliton	Mahmutaj	Pikëzim	I vetëm me problem të sociale- ekonomike, i pa punëprej vitesh .	Lagjia nr.1
19.	Silvana	Dhimpali	Pikëzim	E vetëm problem social-ekonomike.	Lagjia nr.1
20.	Arben	Bagashi	Pikëzim	Familje me problem sociale-ekonomike dhe shëndetësore.	Lagjia nr.2
21.	Shkenca	Kullau	Pikëzim	E vetme mbi moshe pune me problem te theksuara social-ekonomike.	Lagjia nr.1

22.	Basri	Arapi	Pikëzim	Familje me problem të theksuara ekonomike, të pa punë, problem shëndetësore K.8	Lagjia nr.1
23.	Haire	Hameti	Pikëzim	E vetme me problem social-ekonomike.	Nj.Adm Sinjë
24.	Artur	Druga	Pikëzim	I vetëm me problem social-ekonomike.	Lagjia nr.1
25.	Ilirjana	Mahilaj	Pikëzim	E divorcuar, pa streh problem social-ekonomike.	Lagjia nr.1
26.	Foti	Ymeraj	Pikëzim	Familje me përbërje invaliditeti	Lagjia nr.1
27.	Ruzhdi	Plaka	Pikëzim	Familje e pa punë prej vitesh problem social ekonomike.	Lagjia nr.1
28.	Lulëzime	Kallmi	Pikëzim	E divorcuar me probleme social-ekonomike, shëndetësore.	Lagjia nr.3
29.	Sherif	Gini	Pikëzim	Familje me problem të theksuara social-ekonomike,shëndetësore.	Lagjia nr.1
30.	Ermira	Speci	Pikëzim	E divorcuar, problem social-ekonomike.	Lagjia nr.1
31.	Fatbardha	Kotori	Pikëzim	E vetme, problem social-ekonomike	Nj.Adm Otlak
32.	Aferdita	Gjinollari	Pikëzim	E divorcuar pa mundësi për tu integruar në tregu e punës, mbi moshë pune.	Lagjia nr.2
33.	Gëzimi	Ismailaj	Pikëzim	Familje me probleme social-ekonomike, të punë ndër vite.	Lagjia nr.3
34.	Sali	Gashi	Pikëzim	Familje në varfëri, me të ardhura të pakta. K.8	Lagjia nr.3
35.	Gjinovefa	Komaraku	Pikëzim	Kryefamiljare e vetme mbi moshe pune, pa të ardhura	Lagjia nr.3
32.	Lumturi	Qori	Pikëzim	Grua e ve mbi moshë pune problem të theksuara social-ekonomike.	Lagjia nr.3
37.	Dashuri	Tahiri	Pikëzim	E vetem problem social-ekonomike dhe shëndetësore.	Lagjia nr.3
38.	Luiza	Zenuni	Pikëzim K.8	E vetem problem social-ekonomike dhe shëndetësore.	Lagjia nr.3
39.	Enver	Dyrmishi	Pikëzim	Familje me probleme të theksuara social-ekonomike.	Lagjia nr.3
40.	Agim	Bisha	Pikëzim	Familje mbi moshë pune, pa punësi prej vitesh.	Lagjia nr.1

41.	Myfarete	Puçe	Pikëzim	Familje me problem social-ekonomike dhe shëndetësore, në vështirësi të theksuar.	Lagjja nr.3
42.	Alfred	Lezi	Pikëzim K.8	Familje,në vështirësi ekonomike dhe sociale, me fëmijë që ndjekin arsimin e lartë.	Nj.Adm Sinjë
43.	Fatmir	Plaka	Pikëzim	Familje në vështirësi ekonomike dhe sociale, të pa punë prej vitesh.	Lagjja nr.1
44.	Qemal	Sahiti	Pikëzim	Familje me problem social-ekonomike	Lagjja nr.3
45.	Rezart	Mucaj	Pikëzim	Familje me shumë fëmijë, problem social-ekonomike	Nj.Adm Sinjë
46.	Xhevdet	Laraj	Pikëzim	Familje me problem social-ekonomike.	Lagjja nr.3
47.	Skender	Idrizi	Pikëzim	I vetëm problem social-ekonomike dhe shëndetësore	Lagjja nr.1
48.	Luljeta	Zenuni	Pikëzim	E ve vetem problem social-ekonomike dhe shëndetësore.	Lagjja nr.3
49.	Beqir	Mbrakulli	Pikëzim K.8	Familje me shumë problem social-ekonomike, me përbërje PAK, të pa streh	Lagjja nr.1
50.	Nevila	Hoxha	Pikëzim	E vetem problem social-ekonomike dhe shëndetësore pa punë.	Nj.Adm Sinjë
51.	Petrit	Dogër	Pikëzim	Familje mbi moshë pune problem social-ekonomike.	Nj.Adm Otllak
52.	Dallandyshe	Alameti	Pikëzim	E ve me problem të theksuara social-ekonomike	Nj.Adm Otllak
53.	Shkelqim	Gega	Pikëzim	Familje pa të ardhura probleme social-ekonomike dhe shëndetësore	Lagjja nr.2
54.	Nimete	Dervishaj	Pikëzim	E divorcuar problem social-ekonomike.	Lagjja nr.2
55.	Haredin	Dehari	Pikëzim K.8	Familje me problem të mëdha social-ekonomike dhe strehimi	Lagjja nr.1
56.	Mustafa	Lika	Pikëzim	Familje me problem social – ekonomike me përbërje PAK	Lagjja nr.3
57.	Sherif	Ymeri	Pikëzim	I ve problem social-ekonomike.	Lagjja nr.3
58.	Medin	Skenderaj	Pikëzim	Familje prej vitesh e pa punë, problem social-ekonomike	Lagjja nr.3
59.	Fatbardha	Memaj	Pikëzim K.8	Familje në varfëri të theksuar ekonomike.	Nj.Adm Velabisht

Përfitojnë ndihmë ekonomike nga Fondet e Bashkisë, gjithësej për muajin **TETOR 2021**

59 familje me një fond **141.680 lekë**

TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE TETOR 2021.

1. Bastri Arapi – Vlerësim social-ekonomik plotësim kriteresh.
2. Sali Gashi – Vlerësim social-ekonomik plotësim kriteresh.
3. Merita Hasani – Vlerësim social-ekonomik plotësim kriteresh.
4. Lulëzime Kallmi – Vlerësim social-ekonomik plotësim kriteresh.
5. Rezart Muçaj – Vlerësim social-ekonomik plotësim kriteresh.

TË MOS TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE TETOR 2021.

1. Filip Gjika – Mos paraqitur në zyrën e punës.
2. Hartur Ajazi – Mos paraqitur në zyrën e punës.
3. Albana Hoxha – Mos paraqitur në zyrën e punës.
4. Marinela Papa – Mos paraqitur në zyrën e punës.
5. Luan Hado – Mos paraqitur.

KALOJNË NGA FONDET E BASHKISË NË FONDIN 6 % TETOR 2021.

Nuk ka raste.

HIQEN NGA FONDET 6 % DHE KALOJNË NE FONDET E BASHKISË TETOR 2021.

Nuk ka raste.

Bashkëngjitur keni listë pagesën e familjeve TETOR 2021,

PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË N.E/PAK/INV

Evgjeni Pelivani

DREJTORI I KOMANDUAR I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. 6210 Prot.

Berat , më 06.12. 2021

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Z. Ervin Ceca

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues, "Për dhënien e ndihmës ekonomike dhe kompesimit të energjisë elektrike nga bllok-ndihma ekonomike deri në 6 % " për periudhën 01 – 31 Tetor 2021 dhe "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Drejtorisë së Shërbimit Social për periudhën 1 – 31 Tetor 2021".

KRYETARI

Ervin Demo



Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtori Juridik

Konceptoi:

Piro Xheblati: Drejtori i Komanduar i Shërbimit Social

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 % : 4

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit për ndihmën ekonomike nga fondi i Drejtorisë së Shërbimit Social : 3

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues nga bllok-ndihma ekonomike deri në 6 % : 6

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues nga fondi i Drejtorisë së Shërbimit Social : 5